

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Në Shqipëri të vrasin: Në mes të ditës, në mes të vendit!
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1392904.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 11:42:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	20 shtator 2026, 11:26:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 20 shtator 2026, 11:25:00 UTC → 20 shtator 2026, 11:27:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9355f31d1afb4a1efb28671facfc0b10ac4ad77b53150ebd2f2cbb5a1520f2ed
TEKSTI	6c711132c7a1e75988d0c581474a1f04ae720110cc53dc42c68c323fae0ec195
PAMJA	25cd7ef34dd4312779c4edf13755a1e7a08ea3b450c81125ccc2f58f6bf74639

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e46502fa2de2b8eddc62504baa0b4249c368f217ec19005a9cd2a23bdaf2ac60
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	36d3812b75abb32c2d0a144e9d997c17b4f1cdc4fe45cb80665e1d5362027ce4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e46502fa2de2b8eddc62504baa0b4249c368f217ec19005a9cd2a23bdaf2ac60>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Në Shqipëri të vrasin: Në mes të ditës, në mes të vendit!

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 20.09.2026, 13:26



Share



Share



Mëngjesin e sotëm, pamja përrallore e Sarandës bregdetare u zëvendësua nga tmerrri i një breshërie automatiku në zemër të qytetit. Britmat e një nëne që humbi dritën e syve çanë heshtjen e një orari ku rrugët mbushen me jetë, duke lënë pas një viktimë, një kalimtar të pafajshëm të plagosur dhe një qytet të tërë të ngrirë nga frika.

Artan Myrtaj, 44 vjeç, u ekzekutua pa mëshirë nga dy persona mbi motor me skafandra, ndërsa një qytetar i rastit u gjend në kohën dhe vendin e gabuar, i goditur nga sekondat e një lufte që nuk ishte e tij. Kjo ngjarje nuk është më thjesht një ngjarje kronike; është një deklaratë e hapur sfide. Në mes të vendit, në mes të ditës, mesazhi i grupeve kriminale është i qartë, i pastër dhe frikësues: "Ne vrasim kur të duam dhe ku të duam."

Por pyetja që djeg sot çdo qytetar nuk lidhet vetëm me ekzekutorët, por me shtetin: Deri kur?

Saranda prej kohësh nuk po gjen më paqe. Mes shpërthimeve të tritolit dhe plumbave, qytetarët tashmë jetojnë nën psikozën e frikës, ku çdo motor me dy persona të maskuar shikohet si një kërcënim me jetë. Sot e pësoi një kalimtar, po nesër? Sa plumba duhet të përshkojnë hapësirat publike që të kuptohet se një breshëri në një vend të populluar nuk merr vetëm "shënjestrën", por kërcënon fëmijët, gratë, pleqtë dhe çdo njeri që del nga shtëpia pa e ditur nëse do të kthehet më?

Nga ana tjetër, Policia e Shtetit duket çdo ditë e më e pafuqishme, e dorëzuar përpara guximit të krimit të organizuar. Ministrat e Brendshëm që ndërrohen çdo gjashtë muaj si në një lojë karrigesh muzikore nuk kanë sjellë as rend, as siguri e as parandalim. Ndryshimi i emrave në zyrat e ekzekutivit nuk po përkthehet në siguri në rrugët e Shqipërisë.

Ekzekutimi i sotëm në Sarandë është pasqyra e një realiteti ku krimi ka marrë terren dhe shteti vazhdon të mbetet mbrojtës pas ngjarjes, duke numëruar gëzhojat e duke mbledhur lotët e nënave. Edhe sa bij nënash duhet të flijohen mbi asfalt që siguria e jetës të mos jetë më një çështje fati, por një e drejtë e garantuar?/I.Cani

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të



Më të Lexuarat



Albanian
Press
Syndicate

ARTIKULL JOETIK?

urejte. Nëse ju shikon diçka që nuk shikon, jemi të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

[Puno me ne!](#) [Marketing](#) [Politika e privatësisë](#) [Rreth Nesh](#) [Kushtet e përdorimit](#) [Kontakt](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.